



german  
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implementuar nga:

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Në bashkëpunim me:



RAPORT I KONFERENCËS - PËRMBLEDHJE  
Prishtinë, Kosovë

# AGJENDA 2030: HAPAT AFATSHKURTËR DHE AFATMESEM QË DUHET TË NDËRMERREN NGA QEVERIA PËR ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E OZHQ-VE NË KOSOVËS

## Përmbajtje

<b>1. Drejt zbatimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë .....</b>	<b>1</b>
<b>2. Roli i Qeverise në zbatimin e OZhQ-ve si koordinator kryesor kombëtar .....</b>	<b>3</b>
2.1. Shfrytëzimi i mekanizmave institucional ekzistues .....	3
2.2. Qeveria të caktoj zbatimin e objektivave nga institucionet përkatëse dhe të jetë më efektive .....	4
2.3. Të fuqizohet roli i Agjencionit Statistikor të Kosovës në monitorimin e OZhQ-ve.....	6
2.4. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 dhe ndërlidhja me OZhQ-të .....	8
2.5. Koordinimi i punës Kuvend - Qeveri.....	9
<b>3. Veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren në zbatimin e OZhQ-ve .....</b>	<b>10</b>
3.1. Krijimi i një tablele me treguesit relevant për Kosovën duke përfshirë prioritizimin e tyre	10
3.2. Identifikimi i treguesve të OZhQ-ve që aktualisht janë duke u zbatuar.....	11
3.3. Fillimi për monitorimin e OZhQ-ve duke caktuar kornizën e treguesve dhe institucionin përgjegjës .....	13
3.4. Përfshirja e treguesve prioritar në strategjinë kombëtare dhe në strategjitë sektoriale.	14
<b>4. Veprimet afatmesme (2020-2022) për të avancuar zbatimin e OZhQ-ve .....</b>	<b>15</b>
4.1. Strategjia Kombëtare dhe të gjitha Strategjitë Sektoriale të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm specifikisht duke u bazuar në OZhQ .....	15
4.2. Përfshirja e Kosovës në <i>SDGs Dashboard</i> në mënyrë që të mund të krahasohemi me vendet tjera .....	17
4.3. Dërgimi i të dhënave në organizatat statistikore të KB-së .....	18
4.4. Raportimi Vullnetar Kombëtar .....	18
<b>5. Rekomandime .....</b>	<b>20</b>

# 1. Drejt zbatimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë

Në Shtator të vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (KB) miratoi rezolutën mbi "Transformimin e botës sonë: Agjendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm". Kjo agjendë është një plan veprimi për njerëz, planet, prosperitet, paqe dhe partneritet. Kjo agjendë e vitit 2030 ka 17 objektiva, 169 qëllime (targets) dhe 232 tregues unik, treguesit ndahen dhe klasifikohen në 3 nivele. Niveli i parë përfshin treguesit konceptualisht të qartë, që kanë një metodologji të krijuar dhe standardet janë në dispozicion, dhe të dhënat prodhohen rregullisht nga vendet për të paktën 50 përqind të vendeve dhe të popullsisë në çdo rajon ku treguesi është i rëndësishëm. Niveli i dytë përfshin treguesit konceptualisht të qartë, që kanë një metodologji të krijuar dhe standardet janë në dispozicion, por të dhënat nuk prodhohen rregullisht nga vendet. Niveli i dytë përfshin treguesit për të cilët nuk ka metodologji apo standarde të krijuara, por metodologjia/standardet janë duke u zhvilluar ose testuar.

Në nivel global, 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe 169 targetet e agjendës së re duhet të monitorohen dhe rishikohen duke përdorur një sërë treguesish globalë. Korniza globale e treguesve, është zhvilluar nga Agjencia dhe Grupi i Ekspertëve mbi Treguesit e SDG (IAEA-SDG), në bashkëpunim me Komisionin Statistikor të KB. Këshilli Ekonomik dhe Social dhe Asambleja e Përgjithshme e KB-a ka miratuar këta tregues.

Qeveritë gjithashtu duhet të zhvillojnë treguesit e tyre kombëtarë për të ndihmuar në monitorimin e progresit të bërë mbi objektivat dhe targetet. Procesi i monitorimit dhe rishikimit bëhet përmes një Raporti vjetor të Progresit të OZhQ-ve që përgatitet nga Sekretari i Përgjithshëm i KB. Takimet vjetore të Forumit të nivelit të lartë politik mbi zhvillimin e qëndrueshëm luajnë një rol qendror në shqyrtimin e progresit drejt OZhQ-ve në nivel global. Mjetet e zbatimit të OZhQ-ve do të monitorohen dhe rishikohen siç përshkruhet në Agjendën e Veprimit në Addis Ababa, dokumentin përfundimtar të Konferencës së Tretë Ndërkombëtare mbi Financimin për Zhvillim, për të siguruar që burimet financiare të mobilizohen në mënyrë efektive për të mbështetur agjendën e re të zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk janë ligjërish të detyrueshme. Megjithatë, vendet pritet të marrin pronësinë dhe të krijojnë një kornizë kombëtare për arritjen e 17 objektivave. Zbatimi dhe suksesi do të mbështeten në politikat, planet dhe programet e zhvillimit të qëndrueshëm të vendeve. Vendet kanë përgjegjësinë kryesore për monitorimin dhe rishikimin, në nivel kombëtar, rajonal dhe global, në lidhje me

progresin e bërë në zbatimin e objektivave dhe targeteve deri në vitin 2030. Veprimet në nivel kombëtar për të monitoruar progresin kërkojnë mbledhjen e të dhënave cilësore, të qasshme dhe me kohë dhe monitorimin dhe rishikimin rajonal.

Kosova nuk është anëtare e KB por duke pasur parasysh objektivat afatgjate të Qeverisë së Kosovës dhe rëndësisë për të ndërmarrë veprime në fusha me rëndësi kritike për ndërtimin e një bote më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë, Kosova duhet të filloj zbatimin e OZhQ-ve. OZhQ-të janë një thirrje universale për të vepruar për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të përmirësuar jetën dhe perspektivën e të gjithëve. Ky dokument nxjerr në pah hapat që Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë duke adresuar të gjitha 17 objektivat në mënyrë që të kontribuojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në të gjitha sferat. Vlen të theksohet që Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë pasardhësit e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZhM-të). 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me 169 targete/qëllime janë më të gjera dhe shkojnë përtej Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit duke adresuar shkaqet rrënjësore të varfërisë dhe nevojën universale për zhvillim që punon për të gjithë njerëzit. Objektivat mbulojnë tre dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm: rritja ekonomike, përfshirja sociale dhe mbrojtja e mjedisit. Ndryshe nga OZhM-të, objektivat e reja mbulojnë më shumë fusha, me ambicie për të adresuar pabarazitë, rritjen ekonomike, vendet e punës, qytetet dhe fshatrat, industrializimet, oqeanet, ekosistemet, energjinë, ndryshimet klimatike, paqe dhe drejtësi. Objektivat e reja janë universale dhe zbatohen në të gjitha vendet, ndërsa OZhM-të ishin të destinuara për veprim vetëm në vendet në zhvillim. Një tipar kryesor i OZhQ-ve është fokusi i tyre i fuqishëm në mjetet e zbatimit - mobilizimi i burimeve financiare - ndërtimi i kapaciteteve dhe teknologjia, si dhe të dhënat dhe institucionet. Objektivat e reja nënvizojnë se trajtimi i ndryshimeve klimatike është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe çrrënjosjen e varfërisë.

Për ta arritur këtë, të gjithë duhet të jenë të përfshirë, dhe "askush nuk duhet të lihet prapa" përfshirë Kuvendin, Qeverinë, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Kosova është në fillimin e zbatimit të OZhQ-ve dhe përfshirja e të gjithë aktorëve është e nevojshme. Të gjitha organizatat, bizneset, njerëzit, krijuesit e ndryshimeve, aktivistët, njerëzit krijues duhet të ndërmarrin veprime të përbashkëta për çështjet e zhvillimit, por kush duhet të jetë motori për zbatimin dhe monitorim e OZhQ-ve? Pa dyshim që organet shtetërore, përkatësisht Qeveria me dikasterët relevant të saj.

Është për të u përhëndetur që më 25 Janar 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë mbi miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i kësaj rezolute është që Kosova të kontribuojë në zbatimin e OZhQ-ve duke miratuar legjislacion dhe monitoruar aktivitetet e Qeverisë, por fatkeqësisht ende nuk ka

zhvillime konkrete përtej themelimit të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili synon arritjen e 17 objektivave zhvillimore, Këshilli është themeluar më 11 Tetor 2018

OZhQ-të janë bërë gjuha e përbashkët dhe korniza e përgjithshme për zhvillimin, menaxhimin dhe komunikimin e strategjive, qëllimeve dhe aktiviteteve të qëndrueshme. Kjo është një mundësi që edhe Kosova të përfitoj nga këto objektiva dhe të harmonizojë strategjitë e tyre në agjendën e qëndrueshmërisë 2030.

Zbatimi dhe monitorimi i qëllimeve dhe objektivave të OZhQ-ve në lidhje me aktivitetet e Qeverisë është një hap parësor. Ky raport përfshin një vlerësim të hollësishëm të aktiviteteve që duhet të ndërmerret Qeveria në mënyrë që të zbatoj dhe monitoroj OZhQ-të.

Metoda për të zbatuar dhe monitoruar kontributin e Qeverisë në zbatimin e OZhQ-ve janë të përfshira në vijim të këtij punimi duke përfshirë rolin e Qeverisë dhe zhvillimi i masave dhe veprimeve të mundshme përkatëse për të mbuluar parametrat përkatës të qëndrueshmërisë për të avancuar në zbatimin e OZhQ-ve.

## **2. Roli i Qeverisë në zbatimin e OZhQ-ve si koordinator kryesor kombëtar**

### **2.1. Shfrytëzimi i mekanizmave institucional ekzistues**

Zbatimi i suksesshëm i Agjendës 2030 kërkon një qasje të integruar, partneritete dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të institucioneve përgjegjëse, përmes proceseve efektive dhe të përgjegjshme. Avancimi kërkon shkëmbime të përvojave globale dhe rajonale midis vendeve për të identifikuar zgjidhjet për planifikimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së OZhQ-ve.

Përkushtimi i nivelit të lartë politik është shumë i rëndësishëm pasi ndihmon qeverinë të riorientojnë kornizat e politikave, planet dhe buxhetet e tyre për të përmbushur OZhQ-të. Suksesi i OZhQ-ve varet nga aftësia e qeverive për të nxitur bashkëpunimin institucional dhe për të krijuar pronësi në institucione, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Për të qenë e suksesshme, qeverisë i kërkohet të luaj role të shumta njëkohësisht. Duhet të këtë aftësi për të forcuar integrimin e brendshëm institucional dhe koherencën e politikave midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Në të njëjtën kohë, Qeveria duhet të jetë iniciatori kryesorë, duke vepruar si një partner strategjik dhe inkurajues për bizneset, investitorët, filantropitë, universitetet, grupet e qytetarëve, rininë dhe pjesët e tjera të shoqërisë civile. Askush nuk pret që qeveria mund të bëjë gjithçka, por ajo është

në pozicionin më të mirë për të marrë drejtimin dhe për të ri-orientuar burimet, për të koordinuar aftësitë dhe për të maksimizuar të gjitha përpjekjet nga të gjitha palët.

Në avancimin e OZhQ-ve, Qeveria duhet të ketë dy role kryesore siç janë zbatimi dhe monitorimi, këto dy procese duken të ngjashme por janë diametralisht të ndryshme. Ky rol i Qeverisë nuk nënkupton krijimin e institucioneve të reja por ngarkimin dhe ndarjen e detyrave për dikastere të ndryshme Qeveritare për të integruar këtë kornizë brenda Kosovës. Zbatimi duhet të bëhet përmes integritit të treguesve të OZhQ-ve në të gjitha strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

Qeveria duhet të ketë një politikë koherente për të përfshirë OZhQ-të nëpër sektorë, duke siguruar që politikat brenda vendit janë në harmoni me njëra tjetrën. Qeveria duhet të vazhdojë të punojnë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për të promovuar përparimin në të gjithë botën. Objektivat, shpesh të ndërlydhura, mund të kërkojnë marrjen e vendimeve të vështira për politika të ndryshme.

Udhëheqja kombëtare duhet të arrijë në të gjitha nivelet Qeveritare, duke inkurajuar dhe shfrytëzuar të gjitha kontributet për ndikim maksimal. Është shumë e rëndësishme që çdo departament brenda administratës publike të jetë i fuqizuar të angazhohet, të udhëheq përparimin dhe të maksimizojë zbatimin e OZhQ-ve. Trajtimi i kompleksitetit dhe ambicies së Agjendës së vitit 2030 kërkon qasje të integruar që përfshijnë edhe aktorët e jashtëm gjatë gjithë procesit të ndryshimit në një mënyrë sistematike dhe të rregullt. Për shembull, Kosova duhet që përmes mekanizmit institucional të ketë seanca dëgjimore të rregullta dhe punëtori me palë të interesuara të jashtme, duke rritur ndërgjegjësimin. Këto mekanizma gjithashtu duhet të ofrojnë hapësirë dhe mbështetje për shoqërinë civile për të forcuar përgjegjshmërinë dhe ndërmarrjen e reforma të përqendruara në ndryshimin e sjelljes në sektorin privat.

## **2.2. Qeveria të caktoj zbatimin e objektivave nga institucionet përkatëse dhe të jetë më efektive**

Roli dhe përgjegjësitë e Qeverisë janë të ndara me dikastere të ndryshme sipas fushave përkatëse. Në mënyrë që zbatimi i OZhQ-ve të ketë një adresë, secili institucion duhet jetë përgjegjës për treguesit relevant. Për shkak të natyrës të treguesit mund të ketë dy apo më shumë institucione përgjegjëse por gjithmonë njëri nga institucionet duhet të jetë bartës në mënyrë që të rritet llogaridhënia.

Në mënyrë që zbatimi të jetë më i lehtë do të ishte ideale që çdo tregues të ketë një institucion bartës. Lista përfshin 232 tregues mbi të cilët është arritur marrëveshja e përgjithshme. Duhet sqaruar që numri i përgjithshëm i treguesve të listuar në kornizën

globale të treguesve është 244. Mirëpo, pasi që nëntë tregues përsërisin nën dy ose tre objektiva të ndryshme, numri total i treguesve individualë në listë është 232<sup>1</sup>.

Një model i thjeshtë për ndarjen e roleve të institucioneve për zbatim të OZhQ-ve mund të bëhet sipas pesë fushave kryesore si në vijim:

### **Zhvillimi Ekonomik** (Objektiva 1, 2, 8, 12)

- (1) Pa varfëri - Zhdukja e varfërisë së të gjitha formave në të gjithë botën;
- (2) Zero uri - Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme;
- (8) Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike - Nxitja e rritjes ekonomike të vazhduar, përfshirëse dhe të qëndrueshme, e punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë;
- (12) Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm - Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit;

### **Sociale** (Objektiva 3, 4, 5, 10)

- (3) Shëndet i mirë dhe mirëqenie - Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat;
- (4) Arsimit cilësor - Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënësve gjatë të gjithë jetës për të gjithë;
- (5) Barazi gjinore - Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave;
- (10) Zvogëlim i pabarazive - Ulja e pabarazive brenda dhe ndërmjet vendeve;

### **Zhvillimi i Infrastrukturës** (Objektiva 6, 7, 9, 11)

- (6) Ujë i pastër dhe kanalizime - Sigurimi i aksesit në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë;
- (7) Energji e përbalueshme dhe e pastër - Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë;
- (9) Industri, inovacion dhe infrastrukturë - Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit;
- (11) Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme - Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta e të qëndrueshme;

### **Ambienti** (Objektiva 13, 14, 15)

- (13) Veprim për Klimën - Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe efektet e saj;
- (14) Jeta nën Ujë - Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm;

---

<sup>1</sup> Korniza e treguesve global për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe objektivat e Agjendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm

<https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/>

(15) Jeta në Tokë - Mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve të qëndrueshme tokësore, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit;

#### **Qeverisja dhe bashkëpunimi (Objektiva 16 dhe 17)**

(16) Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta - Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;

(17) Partneritet për Objektivat - Rivitalizimi i partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm.

Institucionet ekzistuese duhet të jenë më efektive dhe të kenë të qartë rolin e tyre. Tani në Kosovë nuk kemi ndonjë bazë ligjore apo manual për rolin që institucionet Qeveritare kanë për zbatimin e OZhQ-ve. Përgatitja e një manuali ndihmon në drejtimin që duhet të marrë secili institucion, do të ndihmojë që të rritë fokusin për të arritur dhe integruar OZhQ-të. Planifikimi, pra, mund të ndihmojë të zhvillojë objektivat dhe qëllimet e duhura dhe t'i ndihmojë të gjithë hisedarëve të përqendrojnë përpjekjet e tyre në përmbushjen e OZhQ-ve.

### **2.3. Të fuqizohet roli i Agjencionit Statistikor të Kosovës në monitorimin e OZhQ-ve**

Agjensioni Statistikor është thelbësor në zbatimin e OZhQ-ve, sepse është mbledhësi kryesor i të dhënave që do të përcaktojnë nëse, kur dhe në çfarë mase, janë arritur treguesit dhe standardet për secilën OZhQ.

Agjensioni Statistikor i Kosovës është institucion profesional, i pavarur, bartës dhe shpërndarës i statistikave zyrtare dhe koordinator i statistikave zyrtare të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sipas Ligjit për Statistika Zyrtare, qëllimi i statistikave zyrtare është mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Sigurimi i të dhënave përkatëse, në kohë dhe të përdorshme është thelbësore për Kosovën për të bërë zgjedhje të informuara dhe të zbatojë politika më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm. Në mënyrë që të monitorohen OZhQ-të, ASK duhet që të ketë kapacitete njerëzore dhe administrative. Në shumicën e shteteve, institucioni përgjegjës për sistemin statistikor kombëtarë është përgjegjës edhe për përcjelljen dhe



monitorimin e OZhQ-ve. Ky duhet të jetë rasti edhe në Kosovë, duke i dorëzuar kompetencat e monitorimit agjensionit statistikor.

Për të përmbushur kërkesat e OZhQ-ve dhe të programeve të brendshme të zhvillimit, sistemi kombëtar statistikor do të duhet të adoptojë teknologji të reja dhe të zgjerojë fushën e punës së tyre. Integrimi i të dhënave gjeohapësinore me burimet konvencionale të të dhënave mjedisore dhe socio-ekonomike është veçanërisht i rëndësishëm. Të dhënat gjeohapësinore janë thelbësore për monitorimin e kushteve mjedisore dhe po bëhen shpejt një pjesë thelbësore e infrastrukturës së të dhënave të shumë shteteve. Kombinuar me anketat, ato mundësojnë disagregimin sipas karakteristikave hapësinore, siç janë afërsia me rrugët ose dendësia e popullsisë. Regjistrimet e detajeve të thirrjeve nga telefonat mobil dhe të dhënat e tjera të transaksioneve mund të shtojnë një komponent dinamik në të dhëna.

Siç rekomandohet nga Plani i Veprimit për zbatim të OZhQ-ve i përgatitur në Kejp Toun, (Afrika e Jugut) puna e agjencive statistikore duhet të përfshijë programe për të rritur saktësinë e të dhënave, për të identifikuar keqpërdorimin e statistikave dhe për të inkurajuar shkëmbimin e njohurive midis prodhuesve dhe përdoruesve. Aleatët e mundshëm për të dhëna të hapura dhe të besueshme të zhvillimit përfshijnë akademinë dhe hulumtimet, mediat dhe ndërmjetësues të tjerë të informacionit, qeveritë lokale dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe sektorin privat dhe grupet e qytetarëve. Por përdoruesit e të dhënave nuk janë uniform: secili grup përdorues ka nevojë për lloje të ndryshme të të dhënave në forma të ndryshme. Është gjithashtu thelbësore të shoqërohen të dhënat me metadata të hollësishme dhe të sakta. Politikat për të dhëna të hapura duhet të mbështeten nga korniza ligjore dhe rregullative që lejon agjencinë statistikore të shpërndaj të dhënat lirshëm dhe pa ndërhyrje.

Metadata është shumë e rëndësishme për monitorimin e OZhQ-ve. “Metadata” është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave.

Secili nga 232 treguesit unik ka përshkrimin<sup>2</sup> se si duhet të kalkulohet dhe monitorohet, ky përshkrim përfshin:

- Konceptet dhe definicionet;
- Metodologjia (kalkulimi, disagregimi, trajtimi i vlerave që mungojnë);
- Burimi i të dhënave;
- Dispunueshmëria e të dhënave;
- Kalendari i mbledhjeve dhe publikimit të të dhënave.

---

<sup>2</sup> Databaza për Metadata  
<https://unstats.un.org/sdgs/metadata/>

Agjensioni Statistikor duhet të ndërmarr disa veprime në mënyrë që të filloj monitorimin e OZhQ-ve si në vijim:

- Zhvillimi i një kornize statistikore me cilësi të lartë për matjen e OZhQ-ve;
- Mbështetje për institucionet tjera dhe palët e interesuara në metodologjitë e përdorura për të matur objektivat, qëllimet dhe treguesit e OZhQ-ve;
- Ngritja e kapaciteteve në statistikat e nevojshme për OZhQ-të;
- Identifikimi i boshllëqeve të të dhënave dhe të identifikimi i burimeve të reja të të dhënave;
- Shpërndarja e informacionit dhe të dhënave me palët e interesuara;
- Siguroni udhëzime dhe mbështetje teknike për çështjet e të dhënave për hartuesit e politikave për zbatim të OZhQ-ve;
- Rritja e vetëdijes për treguesit e OZhQ-ve dhe rëndësinë e të dhënave.

#### **2.4. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 dhe ndërlidhja me OZhQ-të**

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është mbajtur në vitin 2011, prandaj një regjistrim tjetër do të identifikoj ndryshimet demografike të cilat kanë ndikim të theksuar në zhvillimin e ardhshëm të popullsisë, si dhe në zhvillimin socio-ekonomik.

Sipas Kombeve të Bashkuara “Regjistrimi i Popullsisë është proces i përgjithshëm i planifikimit, mbledhjes, përpunimit, vlerësimit, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave mbi demografinë ekonomike dhe sociale në nivele më të vogla gjeografike, në një kohë të caktuar, të të gjithë personave në një shtet (vend), ose në një pjesë të kufizuar të shtetit”<sup>3</sup>.

Të dhënat e gjeneruara nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave kanë përdorim të gjerë dhe shfrytëzues të shumtë, duke përfshirë vlerësimin e drejtpërdrejtë të disa treguesve të OZhQ-ve. Në regjistrim është shumë e rëndësishme që disagregimi i të dhënave të bëhet sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, statusit të personave me aftësi të kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike ose karakteristikave të tjera, në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare. Pa një Regjistrim gjithëpërfshirës të Popullsisë, ASK dhe ofruesit e tjerë të statistikave zyrtare, nuk do të mund të prodhojnë këta tregues që janë të rëndësishëm për të parë dhe monitoruar arritjen dhe progresin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

---

<sup>3</sup> Parimet dhe Rekomandimet për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave  
[https://unstats.un.org/unsd/demographic-social/Standards-and-Methods/files/Principles\\_and\\_Recommendations/Population-and-Housing-Censuses/Series\\_M67rev3-E.pdf](https://unstats.un.org/unsd/demographic-social/Standards-and-Methods/files/Principles_and_Recommendations/Population-and-Housing-Censuses/Series_M67rev3-E.pdf)

Regjistrimi i popullsisë dhe banesave është një burim i madh i të dhënave që është përdorur gjerësisht për të monitoruar progresin drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të gjitha ndryshimet e propozuara në regjistrimin e popullsisë do të ndihmojnë në monitorimin e treguesve të OZhQ-ve. Elementet e lidhura me popullsinë janë të pranishme në rreth 40% të treguesve të OZhQ-ve.

## **2.5. Koordinimi i punës Kuvend - Qeveri**

Koordinimi institucional në mes të Qeverisë dhe Kuvendit është i domosdoshëm për zbatim dhe monitorim të OZhQ-ve. Mungesa e qartësisë institucionale, roleve dhe përgjegjësi midis agjencive qeveritare të përfshira në Agjendën e vitit 2030 mund të sfidojnë zbatimin e tyre.

Marrëdhënia midis kuvendit dhe ekzekutivit të qeverisë është komplekse. Në Kosovë ekziston një ndarje kushtetuese që ndan autoritetin dhe përgjegjësitë e këtyre dy pushteteve. Ndërsa ekzekutivi është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe buxhetit, roli i parlamentit është që të miratojë ligje dhe të miratojë planet fiskale. Për më tepër, parlamenti është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit dhe sigurimin e përgjegjësisë për veprimet e saj. Dallimet politike mund të ekzistojnë në lidhje me metodat më të mira për të arritur zhvillimin afatgjatë të një vendi. Por është shumë e dëshirueshme që të punohet drejt një konsensusi në të gjithë spektrin politik në lidhje me treguesit dhe objektivat për zhvillimin e një kombi, madje edhe përtej afatit 2030 të caktuar për OZhQ.

Angazhimi i Kosovës për zbatimin e OZhQ-ve duhet të bëhet nga ekzekutivi dhe të gjitha raportimet në lidhje me progresin bëhen zyrtarisht nga ky pushtet. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që kuvendi është i përjashtuar nga procesi. Që nga fillimi i zbatimit të OZhQ-ve, kuvendi duhet të angazhohet në të gjitha aspektet e planifikimit për zbatim. Kjo jo vetëm për qëllimin politik, por për të nxitur pronësinë e OZhQ-ve nga kuvendi dhe deputetët. Kur ligjet miratohen ose ndryshohen dhe buxhetet duhet të miratohen, kuvendi duhet të ketë parasysh përmbajtjen e atyre ligjeve, dhe të jetë në gjendje të debatojë përfshijë apo përshpejtojë miratimin e ligjeve relevante që zbatohen OZhQ-të, e njëjta duhet të ndodhë edhe me ndarjet buxhetore për zbatim të OZhQ-ve.

Pas miratimit të rezolutës për adoptimin e OZhQ-ve dhe krijimit të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, duhet të fillojë edhe zbatimi i tyre. Në mënyrë që Këshilli të jetë funksional duhet të rregullohet funksionimi i tij. Kjo mund të bëhet përmes një vendimi apo rregullore ku definohen qartë roli i Këshillit, fushëveprimi, përbërja, kryesimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë. Kuvendi duhet të fillojë të ndërmarr veprime dhe të ndikoj përmes miratimit të legjislacionit, buxhetit dhe mbikëqyrjes në zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve. Ky rol kritik i Kuvendit në mbështetjen e zbatimit efektiv të OZhQ-ve do të krijojë një mënyrë efektive dhe të përgjegjshme që prodhon rezultate të qëndrueshme dhe me ndikim.

Disa praktika të mira specifike të identifikuar nga përvojat e kaluara të disa shteteve në mënyrën se si Qeveria duhet të koordinojë zbatimin e OZhQ-ve në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj përshkruhen në vijim.

- **Krijimi i grupit kombëtar për zhvillim:** ky grup punues mund të themelohet nga qeveria për të mbikëqyrur dhe udhëhequr zbatimin e OZhQ-ve. Ky grup duhet të jetë gjithëpërfshirës, jo duke përfshirë vetëm përfaqësues të qeverisë dhe parlamentit, por duhet të përfshijë përfaqësues edhe nga sektori privat dhe shoqëria civile. Ky grup duhet të jetë gjithashtu përgjegjës për raportim në Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kuvend.
- **Rishikimi i planit kombëtar të zhvillimit:** plani aktual kombëtar i zhvillimit duhet të rishikohet duke harmonizuar atë me OZhQ-të për të krijuar një plan kombëtar të vetëm për zhvillim që përfshin angazhimet globale të OZhQ dhe lokalizimin e tyre. Qeveria duhet të raportojë rregullisht në parlament për zbatimin e planit, normalisht në baza vjetore.

### **3. Veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren në zbatimin e OZhQ-ve**

#### **3.1. Krijimi i një table me treguesit relevant për Kosovën duke përfshirë prioritizimin e tyre**

Treguesit e OZhQ-ve ndahen në tre klasifikime (Tier 1 (104 tregues), Tier 2 (89 tregues) dhe Tier 3 (33 tregues)). Kosova duhet të krijojë një kornizë kombëtare që natyrisht mund të ndryshoj nga korniza globale<sup>4</sup>. Kjo nuk kërkon ndonjë mund dhe resurse të larta, mjafton të caktohen tre zyrtar brenda agjensionit statistikor dhe 1 zyrtar brenda zyrës së kryeministrit që të përformojë këtë detyrë dhe të komunikoj me të gjitha institucionet relevante për të identifikuar cilët indikatorë janë relevant për Kosovën. Në prioritizimin e tyre dokumentet referuese mund të jenë si në vijim: Plani Kombëtar për Zhvillim, Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, Programi për Reforma në Ekonomi, Agjenda për Reforma Evropiane, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve si dhe strategjitë sektoriale.

Tabela relevante për Kosovën rekomandohet të krijohet në excel dhe mund të përdoren shembujt si në vijim:

Shembulli 1:

---

<sup>4</sup> Korniza e treguesve global për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe objektivat e Agjendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm  
[https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Frame%20after%202019%20refinement\\_Eng.pdf](https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Frame%20after%202019%20refinement_Eng.pdf)

Republika e Kosovës									
Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm 8 - "Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë"									
Qëllimet	Treguesit	Institucioni përgjegjës	Burimi i të dhënave&Disponueshmëria	Shënime	Njësi	2015	2016	...	2019
8.1 Ruajtja e rritjes së ekonomisë për kokë banori në përputhje me rrethanat kombëtare dhe, veçanërisht, të paktën 7 përqind të rritjes së Bruto Produktit të Brendshëm në vit në vendet më pak të zhvilluara	8.1.1 Shkalla vjetore e rritjes së BPV-së reale për kokë banori	ASK	BPV, BPV me qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit vjetore apo tremujore		%	...	...	...	...

## Shembulli 2:

Republika e Kosovës									
Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm 7 - "Sigurimi i qasjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë"									
Qëllimet	Treguesit	Institucioni përgjegjës	Burimi i të dhënave&Disponueshmëria	Shënime	Njësi	2015	2016	...	2019
7.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë	7.1.1 Përqindja e popullsisë me qasje në energji elektrike	ASK	Anketa xxx - çdo vit	Shuma i referohet popullsisë që ka energji elektrike	%	...	...	...	...
	7.1.2 Përqindja e popullsisë që kanë përdorim parësore lëndë djegëse të pastërta dhe teknologjinë			P.Sh. Shuma i referohet popullsisë që përdor gaz dhe energji elektrike për gatim		...	...	...	...
7.2 ...	7.2.1 ...	...	...	...	%	...	...	...	...

Gjithashtu, krijimi i një **platforme** vendore është shumë e rëndësishme për të shërbyer si regjister kombëtar për zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve. Kjo platformë gjithashtu lehtëson shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës midis partnerëve, kjo platformë duhet të jetë e hapur për të gjitha palët e interesuara, përfshirë shoqërinë civile, autoritetet lokale, sektorin privat, komunitetin shkencor dhe teknologjik, akademinë, dhe të tjerët, për të mundësuar nxitjen për zbatimin të agjendës së vitit 2030 dhe 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo do të duhej të sigurojë azhurnime periodike mbi progresin.

### 3.2. Identifikimi i treguesve të OZhQ-ve që aktualisht janë duke u zbatuar

Kur të krijohet tabela me treguesit relevant për Kosovën atëherë duhet të fillohet me identifikimin e treguesve që veç se janë duke u zbatuar nga institucionet e Kosovës. Tabela e krijuar duhet të dërgohet te të gjitha institucionet relevante sipas fushave në mënyrë që të shohin që përveç zbatimit nëse janë duke e kalkuluar tregues relevant të tyre apo ndonjë tregues të përafërt apo sic njihet "proxy indicator". Duhet të analizohen te gjitha strategjitë dhe planet e veprimit të secilit institucion dhe të shikohet se sa tregues ekzistues mund të adresojnë OZhQ-të.

Për të vlerësuar nëse janë duke u zbatuar tregues në Kosovë që mund të kontribuojnë në zbatimin e OZhQ-ve duhet të fokusoheni në parimet si më poshtë<sup>5</sup>:

- Konceptet dhe definicionet – cili është definicioni i sakt i atij treguesi që është duke u zbatuar në Kosovë dhe si bëhet matja e këtij treguesi. Duhet të dihet cili është qëllimi i këtij treguesi dhe si kontribuon në atë sektor p.sh. *“një ndryshim pozitiv i përqindjes në BPV real vjetor për kokë banori mund të interpretohet si një rritje e standardit mesatar të jetesës së banorëve në një vend ose zonë”*. Gjithashtu, duhet të dihen konceptet specifike p.sh. cka nënkuptoni me Bruto Produktin Vendor? Kjo bëhet në mënyrë që treguesi të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare pasi që disa vende p.sh. mund të përdoren versione të ndryshme të SNA-ve ose përdoren parametra të ndryshëm në mbulimin e ekonomisë joformale për të matur BVP.
- Metodologjia – duhet të shikohet mënyra e kalkulimit të treguesve që janë duke u zbatuar në Kosovë p.sh. si të konvertohet BPV real në monedhën vendore me çmimet e vitit 2010 ose mënyra e kalkulimit të BVP për kokë banori apo mënyra se si kalkulohet rritja e BPV. Të shikohet nëse disagregimi i të dhënave bëhet sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, statusit të personave me aftësi të kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike ose karakteristikave të tjera që kërkojnë treguesit specifik. Te parimi i metodologjisë është e rëndësishme edhe trajtimi i vlerave që mungojnë, pra kur të dhënat e plota nuk janë të disponueshme, një hierarki e burimeve të tjera të të dhënave përdoret për të mbledhur informacione. Të dhënat e mbledhura përdoren ose direkt ose zbatohen procedurat e vlerësimit për të marrë të dhënat e nevojshme;
- Burimi i të dhënave – duhet të dihet burimi i të dhënave, si mbledhen ato të dhëna p.sh. përmes anketave specifike, të dhëna administrative apo regjistrimi i popullsisë, disa tregues mund të kenë burimin e të dhënave edhe nga një organizatë ndërkombëtare. Gjithashtu duhet të shikohet procesi i mbledhjes së të dhënave, dhe koha kur ato të dhëna janë mbledhur;
- Disponueshmëria e të dhënave – këtu duhet të shikohet kush është përgjegjës për të publikuar të dhënat si dhe cilat publikime kohore janë në dispozicion p.sh. vjetore, tremujore, mujore dhe vitet prej cilit vit kanë filluar p.sh. të dhënat vjetore nga viti 2009 deri në vitin 2019 janë në dispozicion;
- Kalendari i mbledhjeve dhe publikimit të të dhënave – është shumë e rëndësishme që për çdo tregues të dihet se kur fillon procesi i mbledhjes së të dhënave dhe kur përfundon ai, p.sh. mbledhja për vlerësime zyrtare vjetore të llogarive kombëtare nga vendet përdorin pyetësoresin e llogarive kombëtare fillon në shkurt të çdo viti për të dhënat e disponueshme deri në fund të vitit paraprak.

---

<sup>5</sup> Manuali elektronik mbi treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm  
<file:///C:/Users/valon.avdiu/Downloads/SDGeHandbook-150219.pdf>

Gjatë identifikimit duhet t'i referohemi të gjitha statistikave zyrtare si dhe statistikave të organizatave ndërkombëtare pasi që disa tregues mund të kalkuloohen edhe nga organizata ndërkombëtare. Pra nëse të dhënat zyrtare nuk janë të disponueshme, zgjedhja e burimeve të të dhënave duhet të bazohet në hierarkinë e mëposhtme<sup>6</sup>:

- Publikimet zyrtare dhe faqet e internetit të zyrave kombëtare të statistikave, bankave qendrore ose ministrive përkatëse qeveritare;
- Statistikat zyrtare të shpërndara nga Eurostat, Banka Qendrore Evropiane dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD);
- Informacioni i ofruar nga Misionet e Përhershme për Kombet e Bashkuara;
- Anketat dhe vlerësimet ekonomike të përgatitura nga Komisionet Ekonomike Rajonale të Kombeve të Bashkuara (UNECE, ECLAC, ESCAP, UNECA dhe ESCWA);
- Publikimet e organizatave ndërkombëtare me një fokus të veçantë në mbledhjen e të dhënave statistikore (përfshirë bankat e zhvillimit rajonal);
- Vlerësimet dhe treguesit e organizatave të tjera ndërkombëtare. Burimet më të zakonshme të përdorura janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore;
- Të dhënat ekonomike nga ofruesit komercial dhe burimet e tjera (burimet më të zakonshme të përdorura janë: Njësia e Inteligjencës Ekonomike dhe Agjensia Qendrore e Inteligjencës e Shteteve të Bashkuara.

### **3.3. Fillimi për monitorimin e OZhQ-ve duke caktuar kornizën e treguesve dhe institucionin përgjegjës**

Pasi të përgatitet një tabelë që përmban tregues relevant për Kosovën duke përfshirë priorizimin e tyre dhe treguesit e identifikuar që aktualisht janë duke u zbatuar nga Kosova, do të mund të filloj monitorimi.

Monitorimi i progresit bëhet bazuar në të dhënat e prodhuara nga sistemi kombëtar statistikor. Me këtë rast duhet të përgatitet një raport i monitorimit. Ky raport duhet të paraqet gjendjen mbi zbatimin e treguesve relevant të OZhQ-ve, progresin e arritur, dhe një vlerësim cilësor të gjendjes aktuale për secilin tregues. Si i tillë, ky raport shërben për vlerësimin dhe përmirësimin e zbatimit të OZhQ-ve dhe për llogaridhënie brenda institucioneve dhe transparencë ndaj publikut. Struktura e raportit duhet të bazohet në kornizën e treguesve të OZhQ-ve. Raporti duhet të jetë një vjeçar dhe të mbuloj periudhën nga Janari deri në Dhjetor.

---

<sup>6</sup> Treguesit e OZhQ-ve - metadata  
<https://unstats.un.org/sdgs/metadata/>

Përgjegjësia kryesore për mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, konsolidimin dhe finalizimin e raportit të monitorimit, duhet të bie mbi Agjensionin Statistikor të Kosovës.

Të dhënat mbi gjendjen rreth zbatimit të secilit tregues duhet të vendosen në rubrikën e viteve për atë tregues relevant dhe të nënvizojë ndonjë vërejtje në rubrikën 'shënime' që gjendet në tabelë.

Raporti vjetor duhet të përmbajë pasqyrën e përgjithshme, pasqyrën në nivel të objektivave dhe pasqyrën mbi secilin tregues të OZhQ-ve. Si model i monitorimit mund të përdoret Raporti mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm i përgatitur nga KB<sup>7</sup>.

Raporti adreson nevojën në rritje për informacion drejt statistikave kombëtare për të mbledhur, llogaritur dhe monitoruar OZhQ-të duke përdorur të dhëna të prodhuara nga sistemet kombëtare të statistikave. Monitorimi gjithmonë duhet të ketë referencë gjithëpërfshirëse që përqendrohet në aspektet kryesore - siç janë konceptet, përkufizimi, burimet, llogaritjet - që janë thelbësore për matjen e treguesve.

### **3.4. Përfshirja e treguesve prioritar në strategjinë kombëtare dhe në strategjitë sektoriale**

Për treguesit që Kosova ende nuk mund t'i monitoroj pasi që nuk kemi të dhëna dhe politika për zbatimin e tyre, atëherë duhet të përfshihen në strategjinë kombëtare për zhvillim dhe strategjitë sektoriale. Në këtë moment duhet të përfshihen vetëm treguesit që janë prioritar për Kosovës duke bërë menjëherë ndryshimet e nevojshme në dokumente strategjike ndërsa treguesit tjerë mund të fillojnë të përfshihen edhe më vonë siç do të shpjegohet në kapitullin e ardhshëm.

Në të gjitha nivelet e qeverisjes është e rëndësishme që në këtë fazë të identifikohen strategjitë dhe planet e zhvillimit në të gjithë vendin pasi kjo krijon një bazë të njohurive për ofrimin e udhëzimeve në lidhje me integrimin vertikal dhe horizontal të politikave dhe treguesve.

Përshtatja e OZhQ-ve në kontekst kombëtar përfshin një proces shumë dimensional ku kërkon një gjithëpërfshirje institucionale në mënyrë që të krijohet koherenca e politikave, identifikimi i sinergjive dhe integrimi i objektivave në kornizat e politikave kombëtare.

---

<sup>7</sup> Raporti global mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2019  
<https://unstats.un.org/sdgs/report/2019/The-Sustainable-Development-Goals-Report-2019.pdf>



Përfshirja e treguesve prioritar në strategjinë kombëtare dhe në strategjitë sektoriale duhet të bëhet duke:

- Rishikuar strategjinë kombëtare dhe planet ekzistuese duke identifikuar fushat për ndryshim. Pasi të analizohen këto në nivelin kombëtar dhe lokal të krahasohen pastaj me objektivat globale për të identifikuar boshllëqet;
- Integruar treguesit prioritar për adresimin e boshllëqeve në strategjitë dhe planet ekzistuese;

Duke përdorur qasjen e shumë palëve të interesit, Qeveria mund të bëjë një analizë duke krahasuar objektivat në planet ekzistuese të zhvillimit me ato të OZhQ-ve për të vlerësuar fushat e përputhshmërisë ose konfliktit, si dhe çdo boshllëk në përmbajtje. Kjo mund të bëhet si në nivelin e 17 objektivave, ashtu edhe në nivelin e 169 qëllimeve.

## **4. Veprimet afatmesme (2020-2022) për të avancuar zbatimin e OZhQ-ve**

### **4.1. Strategjia Kombëtare dhe të gjitha Strategjitë Sektoriale të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm specifikisht duke u bazuar në OZhQ**

Kosova si shumë shtete në të gjithë botën duhet të filloj procesin e lokalizimit të OZhQ-ve. Duke përfshirë bashkëpunimin me partnerët e zhvillimit, Kosova duhet të fillojë të vlerësojë se si të harmonizojë objektivat e OZhQ-ve në strategjinë e zhvillimit kombëtar, Programit Kombëtar për Zbatim të MSA-së, Programin për Reforma Ekonomike, Agjendën për Reforma Evropiane dhe strategjitë tjera sektoriale në nivelin e qeverisjes vendore.

Nga mësimet e marra deri më tani, Kosova duhet të vazhdojë të luftojë korrupsionin, përmirësoj zbatimin e ligjit, të promovojë rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, të rritë produktivitetin dhe punësimin e të rinjve dhe të ofrojë arsim cilësor. Në aspektin e mbrojtjes sociale, programet duhet të përfshijnë prioritetet për shkak të efekteve të tyre të dyanshme - duke siguruar barazi në shpërndarjen e pasurisë dhe krijimin e më shumë vendeve të punës përmes investimeve. Më tej, duhet të bëhen përpjekje për të përmirësuar produktivitetin e sektorit privat. Meqenëse qeverisja është një çelës në këtë proces, sigurimi i koordinimit ndër-institucional përmes mekanizmave ekzistues siç janë grupet e punës është shumë e rëndësishme për të arritur OZhQ-të.

Tre shtyllat që duhet të fokusohet Kosova janë:

Suksesi në zbatimin e Agjendës 2030 do të kërkojë një ankorim të kujdesshëm në përparësitë dhe realitetet kombëtar. Për të harmonizuar strategjinë kombëtare dhe strategjitë sektoriale duhet konsideruar tre faktorë kritikë të suksesit në lokalizimin e OZhQ-ve.

➤ Harmonizimi: përmes Vlerësimit të Shpejtë të Integruar

Një konsideratë e parë në integrimin e OZhQ-ve është të kuptosh shkallën në të cilën korniza e politikave kombëtare integrojnë objektivat e OZhQ-ve. Kjo është thelbësore pasi veprimi nga subjektet qeveritare dhe palët e tjera të interesuara udhëhiqet nga politikat kombëtare të cilat përfshihen në plane dhe strategji operative dhe përcaktojnë shpërndarjen e burimeve për zbatimin e aktiviteteve gjatë periudhave të specifikuara kohore. Për të vlerësuar harmonizimin politikave të Kosovës me objektivat e OZhQ-ve, duhet të përdoret Vlerësimi i Shpejtë i Integruar<sup>8</sup> i KB. Përdorimi i këtij vlerësimi ka një udhëzues që ka për qëllim të mbështesë vendet në përfshirjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në strategjinë kombëtare. Udhëzuesi sugjeron hapa dhe shabllone të qarta për hartuesit e politikave për të kryer një vlerësim të shpejtë të integruar (RIA) të OZhQ-ve për të përcaktuar rëndësinë e tyre me kontekstin e vendit, në nivelin kombëtar, dhe ndërlidhjet midis objektivave. Ky vlerësim është një hap i parë në përcaktimin e një harte për një vend për të zbatuar OZhQ-të.

➤ Koordinimi: Mekanizmat institucionalë

Kosova duhet të pranon që Agjenda 2030 kërkon një ndryshim thelbësor në mënyrën se si ndiqen objektivat e zhvillimit global dhe kombëtar: një mënyrë krejt e re e përcaktimit të prioritetëve dhe politikëbërjes, strategji të reja për zhvillimin koherent dhe zbatimin e lidhur të strategjive dhe përpjekjeve, partneritete të reja dhe më të forta dhe më shumë angazhim nga të gjithë palët e interesuara, kapacitete më të forta për monitorim dhe raportim mbi progresin, dhe investime të reja.

Në zbatimin e OZhQ-ve, strategjia e zhvillimit duhet t'i kushton vëmendje të veçantë koherencës së politikave dhe angazhimit të palëve të interesuara, duke u përqendruar në ndërtimin e sinergjive dhe identifikimin e shkëmbimeve tregtare në sektorë, adresimin e pengesave për të mbështetur dhe përshpejtuar përparimin, ndërtimin e partneriteteve dhe eksplorimin e opsioneve të financimit dhe krijimin e mekanizmave të matjes.

➤ Financimi i OZhQ-ve

---

<sup>8</sup> Vlerësimi i Shpejtë i Integruar  
<https://ëëë.undp.org/content/dam/undp/library/SDGs/RIA%20Tool%20-26.12.201-Final.pdf>

Arritja e prioriteteve ambicioze të zhvillimit kombëtar të Kosovës dhe zbatimi i OZhQ-ve deri në vitin 2030 do të kërkojë investime të rëndësishme në zhvillimin e qëndrueshëm. Një strategji financimi duhet të ketë identifikimin e masave për të siguruar që kufizimet e burimeve financiare nuk bëhen pengesë për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Tre shtyllat që duhet të fokusohet Kosova janë:

- Zbatimi i agjendës së OZhQ-ve në nivelin kombëtar dhe lokal: integrimi në planet kombëtare për zhvillim dhe çka është shumë e rëndësishme alokimet buxhetore;
- Përshpejtimi duke u përqendruar në fushat me përparësi, duke pasur një qasje të integruar, si dhe duke i japur rëndësi financimit dhe partneritetit;
- Mbështetje e politikave, duke shfrytëzuar aftësitë dhe përvojën ekzistuese si dhe duke shfrytëzuar agjencitë përkatëse të KB, të cilat janë në dispozicion me një kosto të ulët.

#### **4.2. Përfshirja e Kosovës në *SDGs Dashboard* në mënyrë që të mund të krahasohemi me vendet tjera**

Kjo databazë interaktive është një iniciativë e nxitur nga të dhënat që mbështetin dhe monitorojnë objektivat globale të Kombeve të Bashkuara. Platforma aktualisht përdor të dhëna nga baza e të dhënave globale e Divizionit të Statistikave të KB (UNSD), e cila u hap në prill 2018, në një mënyrë që lejon përdoruesit të eksplorojnë dhe vizualizojnë të dhënat për të analizuar progresin. Kosova nuk është pjesë e kësaj databaze dhe duhet të filloj kontaktet që të bëhet pjesë e saj<sup>9</sup>.

Kjo databazë iu mundëson Qeverive, hartuesve të politikave, studiuesve, akademikëve, antropologëve dhe të tjerëve të interesuar për gjurmimin e OZhQ-ve për të kryer analiza të thjeshta përmes vizualizimeve inovative dhe mjeteve për të eksploruar të dhënat nga burimet globale të të dhënave.

Përdoruesit mund të përshtatin panelin e të dhënave interaktive të OZhQ-ve për të monitoruar përparimin e vendit të tyre sa i përket OZhQ-ve, dhe të eksplorojnë trendet në OZhQ-të, treguesit dhe objektivat e veçanta. Për të eksploruar një objektivë të veçantë, databaza mundëson përdoruesit të vizualizojnë të dhënat në hartat tematike, grafikët, tabela, dhe rezultate të tjera.

---

<sup>9</sup> Databaza interaktive për SDGs  
<http://ëëë.sdgsdashboard.org/>

Platforma interaktive përfshinë aftësinë për të lidhur të dhënat e zyrës kombëtare të statistikave dhe bazave të të dhënave qeveritare me SDGs Dashboard. Një mjet i njohur si "Qytetarët Votojnë" lejon përdoruesit të identifikojnë gjashtë çështjet që janë më të rëndësishme për ta, nga gjithsej 16 çështje, duke filluar nga çështjet e arsimit deri tek veprimet e ndërmarra për ndryshimin e klimës. Përdoruesit pastaj mund të shohin se si përparësitë e tyre krahasohen me të tjerët, dhe shikojnë përparësitë në të gjithë botën. Votat regjistrohen me gjininë, moshën, nivelin e arsimit dhe vendndodhjen e përdoruesit.

### **4.3. Dërgimi i të dhënave në organizatat statistikore të KB-së**

Kosova duhet të ketë prioritet që të dhënat e saj të disponueshme të dërgohen në të gjitha organizatat ndërkombëtare. Kosova aktualisht dërgon të dhënat e saj në Eurostat por jo edhe në organizata të Kombeve të Bashkuara.

Janë 36 agjenci brenda Kombeve të Bashkuara dhe 12 jashtë saj. Secili agjencion ka si përgjegjësi kryesore disa tregues. Kjo tregon kompleksitetin e punës bashkërenduese në prodhimin e statistikave globale për treguesit e OZhQ-ve, dhe të dhënat rrjedhin nga shtetet drejt agjencive kujdestare dhe, më pas, në bazën e të dhënave globale të organizuar nga UNSD, e cila më pas përdoret për raportet globale të progresit për arritjet e agjendës së vitit 2030. Kjo analizë ka për qëllim që për fillim të kuptojë sfidat për të koordinuar punën në prodhimin e statistikave globale për treguesit e OZhQ-ve dhe për të përmirësuar transparencën dhe efikasitetin e prodhimit të statistikave në nivel global.

Kosova duhet të filloj kontaktet me agjencionet e KB për secilin tregues të OZhQ-ve që Kosova ka të dhëna në mënyrë që t'i dërgoj këto të dhëna për publikim në nivelin global.<sup>10</sup>

### **4.4 Raportimi Vullnetar Kombëtar**

Si pjesë e mekanizmave për monitorimit dhe raportimit, Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm inkurajon vendet anëtare "të kryejnë raportime të rregullta dhe gjithëpërfshirëse të përparimit në nivelin kombëtar, këto raportime udhëhiqen nga vet shteti dhe nxitja duhet të filloj nga vet shteti" (paragrafi 79 i agjendës 2030). Këto raportime kombëtare pritet të shërbejnë si bazë për raportimet e rregullta nga forumi politik i nivelit të lartë (HLPF), ky forum mbahet rregullisht njëherë në vit, takimi i fundit është mbajtur më 9 deri 18 Korrik 2019 në Nju Jork ndërsa takimi tjetër pritet të mbahet më 7 deri 16 Korrik 2020. Siç përcaktohet në paragrafin 84 të Agjendës 2030, raportimet e rregullta nga HLPF duhet të jenë vullnetare, të udhëhequra nga shteti dhe të përfshijnë të gjitha palët e interesuara.

---

<sup>10</sup> Për më shumë referoju dokumentit për sistemin e agjencive kujdestare për treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm [https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/2018/CES\\_39.pdf](https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/2018/CES_39.pdf)

Raportimet vullnetare kombëtare (RVK) synojnë të lehtësojnë shkëmbimin e përvojave, përfshirë sukseset, sfidat dhe mësimet e marra, me qëllim të përshejtimit të zbatimit të Agjendës së vitit 2030. RVK-të gjithashtu kërkojnë të forcojnë politikat dhe institucionet e qeverive dhe të mobilizojnë mbështetje dhe partneritete shumë-palësh për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për këtë arsye edhe Kosova duhet të filloj përgatitjet për raportim vullnetar kombëtar, ky raport duhet të përshkruaj veprimet që Kosova po ndërmerret për të zbatuar Agjendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, për të ndihmuar në krijimin e një vendi më të barabartë, më të prosperuar dhe më gjithëpërfshirëse. Ky raport duhet të nënvizoj arritjet dhe sfidat me të cilat përballlet Kosova, dhe duhet të nënvizoj strategjitë për të ecur përpara duke vazhduar zbatimin e Agjendës 2030.

Përveç tjerash Kosova do të ketë mundësinë që të promovoj veten e saj pasi që ekziston një platformë e raportimit në internet në website të OKB-së e cila është e dedikuar për të përpiluar informacione nga vendet pjesëmarrëse në raportimet vullnetare kombëtare të forumit politik të nivelit të lartë për zhvillim të qëndrueshëm.

Nëse Kosova vendos të bëjë një raportim, edhe pse nuk jemi vend anëtar, ky vendim i komunikohet Presidentit të Këshillit ECOSOC me anë të një letre nga Përfaqësuesi i Përhershëm ose një zyrtar tjetër i Kosovës, kjo përcakohet në doracak. Ekzistojnë një numër hapash të tjerë që Kosova duhet të marrë parasysh gjatë organizimit dhe përgatitjes së raportimit.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Për informacion shtesë referoju doracakut për përgatitjen e RVK:  
[https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20872VNR\\_hanbook\\_2019\\_Edition\\_v4.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20872VNR_hanbook_2019_Edition_v4.pdf)

## 5. Rekomandime

- Të intensifikohet angazhimi për zbatimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë.
  - Qeveria të ketë rolin si koordinator kryesor kombëtar në zbatimin e OZhQ-ve.
  - Të shfrytëzohen mekanizmat institucional ekzistues për koordinim, zbatim dhe monitorim.
  - Të jenë më efektive institucionet ekzistuese dhe të kenë të qartë rolin e tyre për sa i përket zbatimi të OZHQ-ve.
  - Qeveria të caktoj zbatimin e objektivave në institucionet përkatëse dhe të kërkoj përgjegjësi nga ato.
  - Të fuqizohet roli i Agjencionit Statistikor të Kosovës në monitorimin e OZhQ-ve.
  - Të forcohet koordinimi për zbatim të OZhQ-ve në mes të Kuvendit dhe Qeverisë.
  - Të mbahet regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 sipas standardeve ndërkombëtare dhe të nxjerren treguesit relevant për monitorim të OZhQ-ve.
- Qeveria të ndërmarrë veprimet e menjëhershme për të mos mbetur edhe më mbrapa në zbatimin e OZhQ-ve.
  - Të krijohet një tabelë me treguesit relevant për Kosovën duke përfshirë prioritizimin e tyre.
  - Të identifikohen treguesit e OZhQ-ve që aktualisht janë duke u zbatuar në Kosovë.
  - Të filloj monitorimi i OZhQ-ve duke përdorur kornizën e treguesve dhe metodave statistikore.
  - Të përfshihen treguesit prioritar në planin kombëtar për zhvillim dhe në strategjitë sektoriale.
- Qeveria të ndërmarr veprimet afatmesme (2020-2022) për të avancuar zbatimin e OZhQ-ve.
  - Strategjia Kombëtare dhe të gjitha Strategjitë Sektoriale të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm specifikisht duke u bazuar në OZhQ.
  - Të përfshihet Kosova në *SDGs Dashboard* në mënyrë që të mund të krahasohemi me vendet tjera.
  - Të dërgohen të dhëna në organizata të ndryshme statistikore të KB-së.
  - Të përgatitet dhe publikohet Raportimi Vullnetar Kombëtar.